

V E N D I M
Nr. 43, datë 17.1.1998

PËR ORGANIZIMIN E PANAIREVE DHE EKSPOZITAVE TREGTARE

(Ndryshuar me vendimin nr. 22, datë 21.1.1999; nr. 438, datë 2.7.2004)

(I përditësuar)

Me propozimin e *Ministrit së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë*, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Panairët dhe ekspozitat tregtare, si dhe veprimtaritë tregtare të ngjashme me to në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, të organizohen vetëm në mjedise të specializuara e të përshtatshme. Në këto raste merret më parë miratimi i institucioneve, që kanë në varësi këto mjedise.

2. Panairët dhe ekspozitat tregtare, kombëtare e ndërkombëtare të organizohen në bashkëpunim me shoqëritë e specializuara për organizim panairesh, sipas një kalendari vjetor, ku të përcaktohen lloji, koha e vendi ku ato do të zhvillohen dhe subjekti që do t'i organizojë.

Kalendari të përgatitet nga Qendra Kombëtare e Panaireve dhe të miratohet nga Ministri i Ekonomisë, brenda muajit shtator të çdo viti, për vitin pasardhës.

2/1. Dhomat e tregtisë dhe të industrisë, si dhe shoqatat e ndryshme të biznesit të organizojnë panairë dhe ekspozita tregtare, kombëtare e ndërkombëtare, sipas kalendarit vjetor të përgatitur nga Qendra Kombëtare Panaireve.

Panairët vendore të organizohen nën drejtimin e dhomave përkatëse të tregtisë dhe të industrisë, me mbështetjen e organeve të pushtetit vendor.

3. Shoqëritë vendase apo të huaja, që merren me organizimin e panaireve dhe të ekspozitave tregtare, brenda muajit qershor të çdo viti të bashkëpunojnë dhe të lidhin marrëveshjet përkatëse me Qendrën Kombëtare të Panaireve për panairët dhe ekspozitat tregtare, që ato do të organizojnë për vitin paraardhës.

4. Për të bashkërenduar veprimtaritë e panaireve dhe të ekspozitave tregtare ngarkohet Qendra Kombëtare e Panaireve, me cilësinë e personit juridik, publik, jobuxhetor, me seli në Tiranë, e cila është në varësi të Ministrit së Ekonomisë. Statuti i kësaj qendre miratohet nga Ministri i Ekonomisë.

5. Shfuqizuar.

6. Pasuria që ka në përdorim panairi i Tiranës, si dhe buxheti i parashikuar për gjashtëmujorin e parë të vitit 1998 për panairin e Tiranës i kalojnë Qendrës Kombëtare të Panaireve.

7. Ngarkohen Ministri i Ekonomisë, Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

8. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 411, datë 22.8.1994 “Për krijimin e panairit të Tiranës” dhe nr.57, datë 11.9.1978 “Për miratimin e rregullores për përgatitjen e ekspozitave dhe pavioneve në panairët ndërkombëtarë” shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet e tij nga data 1 janar 1998.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano